

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

**Auditim
(zgjidhjet)**

P6

Data 29/01/2022

Detyra 1

Ju jeni auditori i Monika Shpk dhe gjatë auditimit ligjor të fundvitit keni identifikuar pikat e mëposhtme të rëndësishme në lidhje me sistemin e kontrollit të blerjeve:

- i. Ndryshimet në dosjen kryesore të të pagueshmeve mund të bëhen vetëm nga Drejtori Menaxhues (DM). Qasja në skedarin kryesor është e kufizuar në DM përmes fjalëkalimit.
- ii. Një printim nga skedari kryesor nxirret periodikisht nga DM dhe krahasohet me të dhënat themelore të sistemit për t'u siguruar që nuk është ndryshuar pa autorizim.
- iii. Gjendjet e librit të llogarive të pagueshme rakordohet me kartelat e furnitorit nga Z. Agoni, i cili është përgjegjës për përpunimin e blerjeve dhe të pagueshmeve. Të gjitha barazimet mbahen në dosje për të ndihmuar në përgatitjen e akrualeve të fundvitit dhe në rastet e pagesave të kontestuara.
- iv. Në fund të muajit Z. Agoni printon një regjistër të të pagueshmeve të vjetra dhe u shkruan çeqe të gjithë furnitorëve me shuma në kolonën "70 ditë e lart". Më pas ai ia paraqet çeqet DM së bashku me një kopje të regjistrit të të pagueshmeve të vjetra. DM shqyrton çeqet dhe i përputhë të pagueshmet me listën e autorizuar të furnitorëve në dosjen kryesore. Më pas DM i nënshkruan çeqet dhe Z. Agoni ua dërgon me postë furnitorëve.
- v. Të gjitha shpenzimet mbështeten me fatura, siç kërkohet nga politika e kompanisë. Të gjitha kërkesat për pagesë janë të autorizuar nga DM, i cili kontrollon nëse faturat janë dëshmi të mjaftueshme dhe nëse shpenzimet janë relevante për biznesin.

Kërkohe:

- (a) Diskutoni pikat e forta në sistemin e kontrollit të blerjeve dhe të detyrimeve të Monika Shpk. (6 pikë)
- (b) Përshkruani testet e kontrolleve që ju si auditor i Monika Shpk duhet të kryeni për të vlerësuar nëse kontrollet funksionojnë në mënyrë efektive. (6 pikë)
- (c) Përshkruani objektivat e përgjithshme të auditorit, kur kryen një auditim në përputhje me SNA 200 Objektivat e Përgjithshme të Auditorit të Pavarur dhe kryerja e një auditimi në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. (4 pikë)
- (d) Tregoni të drejtat e auditorëve (4 pikë)

[Gjithsej: 20 pikë]

Zgjidhja

(a) dhe (b)

Pikat e forta në sistem	Testet e kontrollit
Ndryshimet në skedarët kryesorë të të pagueshmeve mund të kryhen vetëm nga DM. Kjo parandalon ndryshimet e paautorizuara në skedarin kryesor, p.sh. krijimi i një furnitori të rremë.	Auditori duhet të përdorë të dhënat testuese dhe të fusë një fjalëkalim "të rremë" në skedarin kryesor të të pagueshmeve për të siguruar që nuk është dhënë qasja
Të dhënat e skedarit kryesor rishikohen nga DM në mënyrë periodike për t'u siguruar që nuk janë ndryshuar. Kjo siguron që ndryshimet e paautorizuara të identifikohen dhe zgjidhen në kohën e duhur.	Për një mostër muajsh, inspektoni skedarin kryesor të printuar dhe për një mostër ndryshimesh kërkoni nga DM të shpjegojë arsyen e ndryshimit.
Z. Agoni kryen rakordimet e kartelave të furnitorëve dhe përgatit çequet, por nuk nënshkruan çeqe. Ndarja e detyrave parandalon ndjeshëm mashtrimin dhe gabimin.	Vëzhgoni procesin e kryerjes së rakordimeve të furnitorëve duke u siguruar që ai të kryhet nga Agoni. Përndryshe, inspektoni një mostër të rakordimeve të furnizuesit për dëshmi të nënshkrimit të Agonit që konfirmon se është kryer nga ai.
Katelat e furnizuesit (dhe rakordimet pasuese) mbahen në dosje. Kjo krijon një gjurmë auditimi për të konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e bilanceve të pagueshme në fund të vitit.	Kërkoni të inspektoni dosjen e rakordimeve për t'u siguruar që ato mbahen.
DM shqyrton çequet përpara se t'i nënshkruajë dhe i kontrollon ato përsëri në listën e autorizuar të furnitorëve. Kjo parandalon kryerjen e pagesave ndaj furnitorëve të rremë ose për shuma të pasakta dhe siguron që të përfitohen kushtet e plota të kredisë.	Vëzhgoni procesin e plotësimit të çeqeve duke u siguruar që Agoni t'i bashkangjisë çeqeve librin e llogarive të pagueshme dhe DM e shqyrton këtë. Për një mostër të pagesave të bëra për furnitorët gjatë vitit, krahasoni me listën e autorizuar të furnitorëve për t'u siguruar që po paguhen vetëm furnitorët e vlefshëm.
Kërkesat për shpenzime gjithmonë mbështeten me fatura dhe të gjitha kërkesat janë të autorizuara nga DM. Kjo parandalon përpunimin e pretendimeve mashtruese	Për një mostër të pagesave të shpenzimeve të regjistruara në sistem, inspektoni faturat përkatëse dhe dokumentet mbështetëse të nënshkruara nga DM për të autorizuar pagesën si një shpenzim i vlefshëm biznesi.

(c)

- Merrni siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.
- Shprehni një opinion nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me një kornizë raportuese në fuqi.
- Raportoni mbi pasqyrat financiare dhe komunikoni siç kërkohet nga SNA, në përputhje me gjetjet e auditorit.

(d)

- Qasje në librat dhe llogaritë e kompanisë dhe filialeve të saj;
- qasje në informacione dhe shpjegime nga drejtorët dhe punonjësit e kompanisë;
- të njoftohet për mbledhjet e përgjithshme të kompanisë dhe të marrë pjesë dhe të drejtojë mbledhjet;
- shpjegoni në një mbledhje të përgjithshme rrethanat e çdo propozimi për tu larguar ata si auditor dhe për të kundërshtuar atë largim.

Detyra 2

Interrot Shpk (Interrot) është një klient i firmës suaj. Kompania është ballafaquar me vështirësi të konsiderueshme tregtare në vitet e fundit. Puna e auditimit në terren për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 ka përfunduar dhe janë vërejtur çështjet në vijim.

(i) Interrot është duke shkelur kushtet e marrëveshjes të saj bankare në fund të vitit. Menaxhmenti tregoi se është mbajtur një takim me bankierët e kompanisë në të cilin ka marrë garanci nga banka se asnjë nga produktet financiare të kompanisë nuk do të tërhiqej. Interrot ka një hua me afat pesë-vjeçar prej 600,000 Euro dhe një mbitërheqje prej 250,000 Euro.

(ii) Interrot ka një investim financiar prej 50,000 Euro në një kompani të quajtur Vista Shpk (Vista). Investimi nuk e kualifikon Vista për t'u trajtuar si një filial i Interrot. Klienti nuk është në gjendje të sigurojë dëshmi për të mbështetur vlerën kontabël të investimit. Drafti i rezultateve të Interrot për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 paraqet të hyra prej 9.5 milionë euro, një humbje para tatimit prej 500,000 Euro dhe pasuri neto prej 2.5 milionë Euro. Nuk janë vërejtur çështje të tjera nga puna e kryer audituese.

Kërkohet:

(a) Hartoni një memorandum për partnerin e auditimit që përcakton evidencën e auditimit që duhet të merret në lidhje me çështjet e përmendura më sipër dhe duke përshtetur ndikimin e mundshëm në raportin e auditimit. (12 pikë)

(b) Në takimin e planifikimit për këtë angazhim, partneri i auditimit vuri në dukje se standardi i raporteve të auditimit që po hartoheshin nga seniorët e auditimit ishte i dobët. Rekomandoni një numër kontrollesh që duhet të kryhen në raportet e auditimit përpara nënshkrimit. (5 pikë)

(c) Sipas ISA 706 – Paragrafët e theksimi të çështjes dhe paragrafët e çështjeve të tjera në Raportin e Auditorëve të Pavarur, listoni tre raste kur mund të përfshihet një paragraf “theksimi i çështjes” në raport. (3 pikë)

[Gjithsej: 20 pikë]

Zgjidhja

(a)

Memo për: Partnerin e auditimit

Nga: A. Senior

Më poshtë janë dëshmitë e auditimit që kërkoj dhe implikimi që unë shoh për opinionin e auditimit në lidhje me çështjet e ngritura në lidhje me kompaninë e mësipërme:

(i) Shkelja e kushteve të marrëveshjes

Menaxhmenti ka treguar se ata kanë marrë garanci nga banka e saj se asnjë nga produktet e financimit nuk do të tërhiqej. Me lejen e klientit, propozoj të komunikojmë drejtpërdrejt me bankën dhe t'i kërkojmë që të na konfirmojë këtë me shkrim. Nëse marrim një konfirmim të tillë, kjo do të ishte pjesë e bazës për konkluzionin tonë nëse kompania është në vijimësi. Asetet neto të kompanisë janë 2.5 milionë euro. Nëse kompania mund të vazhdojë sipas hipotezës së vijimësisë në të ardhmen e parashikueshme, do të varet nga kapitali qarkullues i kompanisë, të cilën unë do ta hetoj më tej. Me kusht që ky hetim të rezultojë pozitiv, atëherë çështja nuk do të ketë implikime për raportin tonë të auditimit. Nëse nuk merret konfirmim nga banka dhe ajo deklaron se nuk ka dhënë garanci se asnjë nga produktet e financimit nuk do të tërhiqet, atëherë ekziston një çështje e vazhdueshme dhe kërkon shqyrtim të mëtejshëm. Nëse arrijmë në përfundim, pas analizës tonë të të gjitha fakteve përkatëse, se është e përshtatshme të përgatiten pasqyrat financiare mbi bazën e vijimësisë dhe se shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare janë të përshtatshme, atëherë duhet të jepet një paragraf shpjegues në raportin e auditimit duke iu referuar shpalosjeve përkatëse. Nëse i konsiderojmë shpalosjet si të pamjaftueshme, por që entiteti është në vijimësi, ne duhet ta kualifikojmë raportin e auditimit mbi bazën e një kualifikimi të tipit me përjashtim të mosmarrëveshjes, si dhe duke dhënë një paragraf shpjegues që përshkruan pasigurinë materiale për vijimësinë. Nëse pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e vijimësisë dhe ne nuk pajtohem me këtë bazë dhe efekti i përdorimit të kësaj baze është aq material ose i përhapur sa që pasqyrat financiare janë seriozisht mashtruese, duhet të jepet një opinionin i kundërt i auditimit.

(ii) Vlera kontabël e investimit

Kompania nuk mund të na ofrojë dëshmitë që kërkojmë për të mbështetur vlerën kontabël të investimit në Vista. Ne duhet të përcaktojmë nëse ka ndonjë dëshmi alternative që mund të përdorim për të mbështetur vlerën kontabël. Do të përpiqem të marr pasqyrat e fundit financiare të lëshuara nga Vista dhe të rishikoj pozicionin neto të aseteve të kompanisë. Nëse nuk ka prova alternative të disponueshme, atëherë ekziston një kufizim i mundshëm i çështjes së fushëveprimit. Zhvlerësimi maksimal është 50,000€ që do të zvogëlonte asetet neto të kompanisë dhe do të rriste humbjen për atë shumë. Duke pasur parasysh natyrën me humbje të kompanisë, mund të argumentohet se shuma është materiale dhe nëse konkludojmë se është kështu, atëherë kjo do të çonte në një kualifikim "Përveç për" për shkak të kufizimit të fushëveprimit.

Kualifikimi

- Dëshmia e disponueshme ishte e kufizuar, nuk ka dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit lidhur me vlerën kontabël të investimit financiar në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerë prej 50,000€. Çdo rregullim në këtë shifër do të kishte një efekt në humbjen e vitit. Nuk ka procedura të tjera të kënaqshme të auditimit që mund të kryhen për të konfirmuar se vlera kontabël e investimit financiar ishte e saktë.
- Opinioni i kualifikuar që rrjedh nga kufizimi në fushëveprimin e auditimit

(c) Më poshtë janë kontrollet që duhet të kryhen në raportet e auditimit përpara nënshkrimit -

- Sigurohuni që referencat ligjore janë të sakta,
- Sigurohuni që referencat e faqeve u referohen faqeve aktuale të pasqyrave financiare që auditohen,

- Rezultati i saktë pasqyrohet në paragrafin e opinionit, p.sh. një fitim ose një humbje,
- Sigurohuni se ka konsistencë me kornizën e raportimit përkatës,
- Kontrolloni emrin e kompanisë që auditohet dhe fundi i vitit është i saktë,
- Sigurohuni që opinionit përfundimtar i auditimit është i saktë, dmth i pakualifikuar ose i kualifikuar,
- Sigurohuni se ka konsistencë formulimi standard të raportit të auditimit sipas SNA

(d) ISA 706

Shembuj të rrethanave kur audituesi mund ta konsiderojë të nevojshme përfshirjen e një paragrafi të Theksimit të Çështjes janë:

- Një pasiguri në lidhje me rezultatin e ardhshëm të çështjeve gjyqësore të jashtëzakonshme ose veprimeve rregullatore.
- Zbatimi i hershëm (aty ku lejohet) i një standardi të ri kontabël (për shembull, një Standard i ri Ndërkombëtar i Raportimit Financiar) që ka një efekt të përhapur në pasqyrat financiare përpara datës së hyrjes në fuqi.
- Një katastrofë e madhe që ka pasur ose vazhdon të ketë një efekt të rëndësishëm në pozicionin financiar të kompanisë.

Detyra 3

Ju jeni mbikëqyrësi i auditimit në firmën Manga Audit dhe aktualisht po planifikoni auditimin e një klienti ekzistues, Sintexfarm (Sintexfarm), fundi i vitit të të cilit ishte 30 Prill 2021. Sintexfarm është një kompani farmaceutike, e cila prodhon dhe furnizon një gamë të gjerë produktesh mjekësore. Draft pasqyrat financiare tregojnë të hyra prej 35.6 milion Euro dhe fitim para tatimit prej 5.9 milion Euro. Drejtori i mëparshëm financiar i Sintexfarm u largua nga kompania në dhjetor 2020 pasi u zbulua se ai kishte kërkuar rimbursim për shpenzime mashtruese nga kompania për një periudhë të konsiderueshme kohore. Një drejtore e re financiare u emërua në janar 2021, e cila më parë ishte shefe e kontabilitetit në një bankë dhe ajo është shprehur e habitur që Manga Audit nuk e kishte zbuluar mashtrimin gjatë auditimit të vitit të kaluar.

Gjatë vitit Sintexfarm ka shpenzuar 1.8 milionë Euro për zhvillimin e disa produkteve të reja. Këto projekte janë në faza të ndryshme zhvillimi dhe draft-pasqyrat financiare tregojnë shumën e plotë prej 1.8 milion Euro brenda pasurive të patrupëzuara. Për të financuar këtë zhvillim, 2 milionë Euro u morën hua nga banka dhe duhet të shlyhen për një periudhë dhjetëvjeçare. Banka ka kërkuar të plotësohet si kusht fitimi minimal si pjesë e marrëveshjeve të kredisë. Drejtori i ri i financave ka informuar partnerin e auditimit se që nga fundi i vitit ka pasur një rritje të numrit të kthimeve nga shitjet dhe se në muajin maj janë kthyer mbi 0.5 milionë Euro mallra të shitura në prill.

Manga Audit mori pjesë në numërimin e stoqeve në fund të vitit në depon e Sintexfarm.

Auditori i pranishëm ngriti shqetësimin se gjatë numërimit kishte lëvizje të mallrave brenda dhe jashtë depon dhe ky proces nuk dukej i kontrolluar mirë.

Gjatë vitit, u ndërmor një rishikim i impianteve dhe pajisjeve në fabrikë dhe teprica e impiantit u shit, duke rezultuar në një fitim nga shitja prej 210,000 Euro.

Kërkohet:

(a) Përshkruani përgjegjësitë e Manga në lidhje me parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit dhe gabimit. (4 pikë)

(b) Përshkruani GJASHTË rreziqe auditimi dhe shpjegoni përgjigjen e auditorit ndaj secilit rrezik, në planifikimin e auditimit të Sintexfarm. (12 pikë)

(c) Drejtori i ri financiar i Sintexfarm ka lexuar për angazhimet e rishikimit dhe është i interesuar për mundësinë e Manga për t'i ndërmarrë këto në të ardhmen. Megjithatë, ajo nuk është e sigurt se si ndryshojnë këto angazhime nga një auditim i jashtëm dhe sa siguri do të fitohej nga ky lloj angazhimi.

Kërkohet:

(i) Shpjegoni qëllimin e angazhimeve të rishikimit dhe se si ato ndryshojnë nga auditimet e jashtme; dhe (2 pikë)

(ii) Përshkruani nivelin e sigurisë së ofruar nga auditimet e jashtme dhe angazhimet e rishikimit. (2 pikë)

[Gjithsej: 20 pikë]

Zgjidhje

(a) Përgjegjësia e mashtrimit

Manga Shpk duhet të kryejë një auditim në përputhje me SNA 240 Përgjegjësitë e Auditorit në lidhje me Mashtrimin në një Auditim të Pasqyrave Financiare dhe janë përgjegjës për përfundimin e një sigurie të arsyeshme që pasqyrat financiare të marra në tërësi janë pa anomali materiale, nëse shkaktohet nga mashtrimi apo gabimi. Për të përmbushur këtë përgjegjësi, Manga Shpk i kërkohet të identifikojë dhe vlerësojë rreziqet e anomalive materiale të pasqyrave financiare për shkak të mashtrimit. Ata duhet të marrin evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit në lidhje me rreziqet e vlerësuara të anomalive materiale për shkak të mashtrimit, përmes hartimit dhe zbatimit të përgjigjeve të duhura. Gjithashtu, Manga Shpk duhet t'i përgjigjet në mënyrë të përshtatshme mashtrimit ose mashtrimit të dyshuar të identifikuar gjatë auditimit. Kur përfaton siguri të arsyeshme, Manga Shpk është përgjegjëse për ruajtjen e skepticizmit profesional gjatë gjithë auditimit, duke marrë parasysh mundësinë e anashkalimit të kontrolleve nga menaxhmenti dhe duke njohur faktin se procedurat e auditimit që janë efektive në zbulimin e gabimeve mund të mos jenë efektive në zbulimin e mashtrimit. Për të siguruar që i gjithë ekipi i angazhimit është i vetëdijshëm për rreziqet dhe përgjegjësitë për mashtrim dhe gabim, SNA-të kërkojnë që të zhvillohet një diskutim brenda ekipit. Për anëtarët që nuk janë të pranishëm në takim, partneri i angazhimit të auditimit të Sintexfarm duhet të përcaktojë se cilat çështje duhet t'u komunikohen atyre.

Rreziku i auditimit	Përgjigjet e auditorit
Drejtori i mëparshëm financiar i Sintexfarm u largua në dhjetor pasi u zbulua se ai kishte kryer mashtrim në lidhje me shpenzimet e pretenduara. Ekziston rreziku që ai të ketë ndërmarrë transaksione të tjera mashtruese; këto duhet të shlyhen nga pasqyra e të ardhurave në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Nëse këto nuk janë zbuluar, pasqyrat financiare mund të përfshijnë gabime.	Diskutoni me drejtorin e ri të financës se cilat procedura kanë miratuar për të identifikuar çdo mashtrim të mëtejshëm nga drejtori i mëparshëm financiar. Përveç kësaj, ekipi duhet të ruajë skepticizmin e tyre profesional dhe të jetë vigjilent ndaj rrezikut të mashtrimeve dhe gabimeve të mëtejshme.
Drejtori i ri i financës u emërua në janar dhe më parë ishte shef i kontabilitetit të një banke. Sintexfarm është një kompani farmaceutike e cila është shumë e ndryshme nga një bankë; ekziston rreziku që drejtori i ri financiar të mos jetë mjaftueshëm kompetent për të përgatitur pasqyrat financiare, duke çuar në gabime.	Gjatë auditimit, vëmendje e kujdesshme duhet t'i kushtohet çdo ndryshimi në politikat kontabël dhe në veçanti çdo vendim gjykues kyç të marrë nga drejtori financiar.
Gjatë vitit, Sintexfarm ka shpenzuar 1.8 milionë dollarë për zhvillimin e produkteve të reja; këto janë në faza të ndryshme dhe shumata totale është kapitalizuar pasuri e patrupëzuar. Megjithatë, për t'u kapitalizuar duhet të plotësojë të gjitha kriteret sipas SNK 38 Pasuritë e patrupëzuara. Ekziston rreziku që disa projekte të mos arrijnë fazën	Një listë e shpenzimeve të zhvillimit duhet të rishikohet dhe testohet në detaje për të siguruar që vetëm projektet që plotësojnë kriteret e kapitalizimit përfshihen si një pasuri e patrupëzuar, dhe mbetja të shpenzohet.

<p>përfundimtare të zhvillimit dhe për rrjedhojë duhet të shpenzohen dhe jo të kapitalizohen. Pasuritë e patrupëzuara dhe fitimi mund të mbivlerësohen.</p>	
<p>Sintexfarm ka marrë hua 2 milionë dollarë nga banka nëpërmjet një kredie dhjetëvjeçare. Kjo hua duhet të ndahet në mënyrë të saktë midis detyrimeve afatshkurta dhe afatgjata në mënyrë që të sigurohet shpalosje e saktë.</p>	<p>Gjatë auditimit, ekipit do t'i duhet të konfirmojë se financimi i huasë prej 2 milion dollarë është marrë. Përveç kësaj, ndarja ndërmjet detyrimeve afatshkurta dhe afatgjata dhe shpallorjet për këtë kredi duhet të rishikohen në detaje për të siguruar përputhjen me standardet përkatëse të kontabilitetit.</p>
<p>Gjithashtu me rritjen e nivelit të borxhit, duhet të ketë kosto shtesë financiare. Ekziston rreziku që kjo të jetë shmangur nga pasqyra e të ardhurave duke çuar në kosto të nënvlerësuar financiare dhe fitim të mbivlerësuar.</p>	<p>Kostot financiare duhet të rillogariten dhe çdo rritje duhet të përputhet me dokumentacionin e huasë për konfirmimin e normave të interesit si dhe me arkëdhje llogari bankare për të konfirmuar shumën e paguar dhe për rrjedhojë nuk është e pagueshme në fund të vitit.</p>
<p>Huaja ka një kusht të objektivit të fitimit minimal. Nëse kjo shkelet, kredia do të shlyhej menjëherë dhe do të klasifikohet si një detyrim aktual.</p>	<p>Rishikoni llogaritjet e marrëveshjes të përgatitura nga Sintexfarm dhe identifikoni nëse ka ndodhur ndonjë vonesë në kthim të kredisë; nëse po, përcaktoni efektin në kompani.</p>
<p>Nëse kompania nuk ka rrjedhë të mjaftueshme të parasë për të përmbushur shlyerjen e kësaj kredie, atëherë mund të ketë pasoja të vazhdueshme. Përveç kësaj, ekziston rreziku i manipulimit të fitimit për të siguruar që marrëveshjet të përmbushen.</p>	<p>Ekipi duhet të ruajë skepticizmin e tij profesional dhe të jetë vigjilent ndaj rrezikut që fitimi të jetë mbivlerësuar për të siguruar përputhjen me kushtet e huasë.</p>
<p>Ka pasur një numër të konsiderueshëm kthimesh nga shitjet e bëra pas fundit të vitit. Duke qenë se këto kanë të bëjnë me shitjet para fundvitit, ato duhet të hiqen nga draft pasqyrat financiare dhe stoqet të korigjohen. Nëse kthimet nga shitjet nuk janë regjistruar saktë, atëherë të ardhurat do të mbivlerësohen dhe stoqet do të nënvlerësohen.</p>	<p>Rishikoni një mostër të kthimeve të shitjeve pas fundvitit dhe konfirmoni nëse ato kanë të bëjnë me shitjet para fundit të vitit, se të ardhurat janë kthyer dhe stoqet janë përfshirë në regjistrat e fundit të vitit. Gjithashtu, arsyeja e rritjes së nivelit të kthimit duhet të diskutohet me menaxhmentin. Kjo do të ndihmojë për të vlerësuar nëse ka çështje themelore me vlerën neto të realizueshme të stoqeve.</p>
<p>Gjatë numërimit të stoqeve të Sintexfarm në fund të vitit, pati lëvizje të mallrave brenda dhe jashtë. Nëse këto mallra në tranzit nuk do të kontrolloheshin me kujdes, atëherë mallrat mund të hiqeshin ose numëroheshin dy herë. Kjo do të rezultonte në nënvlerësimin ose mbivlerësimin e stoqeve.</p>	<p>Gjatë auditimit përfundimtar, fletëpranimet mallrave dhe fletëdërgesat e mallrave gjatë numërimit të stoqeve duhet të rishikohen dhe të ndiqen në regjistrat e numërimit të stoqeve si të përfshira saktë ose jo.</p>
<p>Teprica e impianteve dhe pajisjeve u shitën gjatë vitit, duke rezultuar në një fitim prej 210,000 dollarë. Duke qenë se ekziston një</p>	<p>Rillogaritni fitimin dhe humbjen në llogaritjet e shitjes dhe rakordoni të gjithë zërat me dokumentacionin mbështetës.</p>

<p>marrëveshje për huanë e fitimit minimal, ekziston rreziku që ky fitim nga shitja të mos jetë llogaritur saktë, duke rezultuar në fitime të mbivlerësuara.</p> <p>Për më tepër, fitimet ose humbjet e rëndësishme nga shitja janë një tregues se politika e zhvlerësimit të makinerive dhe pajisjeve mund të mos jetë e përshtatshme. Prandaj, zhvlerësimi mund të mbivlerësohet.</p>	<p>Diskutoni politikën e zhvlerësimit për makineritë dhe pajisjet me drejtorin financiar për të vlerësuar arsyeshmërinë e saj.</p>
---	--

(c) (i) Angazhimet e rishikimit

Angazhimet e rishikimit shpesh ndërmerren si një alternativë ndaj një auditimi dhe përfshijnë një praktikues që rishikon të dhënat financiare, të tilla si shifrat gjashtëmujore. Kjo do të përfshinte që praktikuesi të ndërmernte procedura për të deklaruar nëse ndonjë gjë i ka rënë në sy që e bën praktikuesin të besojë se të dhënat financiare nuk janë në përputhje me kornizën e raportimit financiar. Një angazhim rishikimi ndryshon nga një auditim i jashtëm në atë që procedurat e ndërmarrja nuk janë pothuajse aq gjithëpërfshirëse sa ato në një auditim, me procedura të tilla si procedurat analitike dhe bisedat me menaxhmentit të përdorura gjerësisht. Përveç kësaj, praktikuesi nuk ka nevojë të jetë në pajtueshmëri me SNA-të pasi këto kanë të bëjnë vetëm me auditimet e jashtme.

(ii) Nivelet e sigurisë

Niveli i sigurisë së ofruar nga angazhimet e auditimit dhe rishikimit është si vijon:

Auditimi i jashtëm – Ofrohet një nivel i lartë, por jo absolut i sigurisë, kjo njihet si siguri e arsyeshme. Kjo ofron siguri që pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale dhe janë pa anomali materiale.

Angazhimet e rishikimit – kur jepet një konkluzion, praktikuesi mbledh dëshmi të mjaftueshme për t'u bindur se çështja është e besueshme; në këtë rast jepet siguri e kufizuar ku praktikuesi konfirmon se asgjë nuk i ka rënë në sy që tregon se çështja përmban anomali materiale.

Detyra 4

Picrraku Shpk (Picrraku) prodhon dhe shet produkte kozmetike dhe higjienike; ata kanë tregtuar për më shumë se 20 vjet, fundviti i kompanisë është 30 shtator 2021. Picrraku u shet produkte klientëve të tij nëpërmjet faqes së vet të internetit; kjo përfaqëson 60% të të hyrave. Të hyrat e mbetura krijohen nga kontratat për furnizimin e hoteleve me produkte tualeti. Më poshtë është një përshkrim i sistemit të shitjes.

Të hyrat nga hotelet

Të hyrat nga hotelet përbëhen nga katër klientë kryesorë. Picrraku ka një nëpunëse shitjeje, Agnesa, e cila mirëmban të gjitha aspektet e kësaj linje të të hyrave; Agnesa merr porositë e klientëve, mbledh faturat e shitjeve dhe përpunon pagesat. Gjatë përgatitjes së faturave, sistemi i shitjeve fut automatikisht çmimet e klientëve të tregtisë online për produktet. Megjithatë, çdo klient hoteli ka kontraktuar çmime të cilat janë më të ulëta se çmimet në internet dhe për këtë arsye Agnesa i modifikon manualisht faturat përpara dërgimit.

Të hyrat nga internet

Klientët e rinj vendosen në dosjen kryesore të librit të shitjeve pas kalimit të kontroleve të përshtatshme të kredisë dhe një kufi kredie vendoset në këtë fazë nga drejtori i financës. Klientët bëjnë porosi online deri në limitin e tyre të paracaktuar të kredisë; ata marrin një konfirmim me email dhe porositë e shitjeve ndërlihen në sistemin e dërgimit. Numri i porosisë është i lidhur me numrin e llogarisë së klientit. Mallrat dërgohen çdo ditë me një shënim të dërgimit të mallrave që i referohet numrit të porosisë së shitjes, por porositë nuk janë të numëruar në mënyrë sekuenciale/njëpasnjëshme. Picrraku dërgonte mallra nëpërmjet një kompanie të besueshme kombëtare korrierësh. Megjithatë, për të ulur kostot, ato janë ndryshuar në një korrier lokal më të lirë dhe disa porosi u janë dorëzuar klientëve me vonesë. Faturat e shitjeve të klientëve gjenerohen automatikisht nga sistemi në ditën kur bëhet porosia online. Çmimet futen në përputhje me tarifën e faqes së internetit. Herë pas here Picrraku bën oferta speciale ose ulje në shitje; kur kjo ndodh, të dhënat e skedarit kryesor duhet të ndryshohen për të siguruar që çmimet e sakta të përdoren në fatura. Kjo detyrë zakonisht kryhet nga një nëpunës i lartë i librit të shitjeve.

Regjistrat e të hyrave dhe të arkëtueshmeve

Në baza mujore kartelat dërgohen te klientët e hotelit; një numër klientësh tregtarë kanë kërkuar kartela mujore dhe Picrraku po shqyrton këtë kërkesë. Kompania rakordon vetëm llogarinë e kontrollit të librit të shitjeve në fund të shtatorit për të verifikuar bilancin e fundvitit.

Kërkohet:

(a) Si auditor i jashtëm i Picrraku Co, shkruani një raport menaxhmentit në lidhje me sistemin e shitjeve të përshkruar më sipër, i cili:

- (i) Identifikon dhe shpjegon SHTATË mangësi në sistemin e shitjeve; dhe
- (ii) jep një rekomandim për të adresuar secilën nga këto mangësi. Kërkohet një letër shoqëruese. (16 pikë)

(b) Përshkruani procedurat thelbësore që auditori duhet të kryejë për të konfirmuar të hyrat e Picrraku Shpk (4 pikë)

[Gjithsej: 20 pikë]

Zgjidhja

(a) Bordi i drejtorëve Picrraku

Të nderuar Zotërinj,

Auditimi i Picrraku (Picrraku)

Ju lutemi gjeni bashkëlidhur raportin drejtuar menaxhmentit për mangësitë në kontrollet e brendshme të identifikuar gjatë auditimi për vitin e mbyllur më 30 shtator 2021. Shtojca e këtij raporti merr në konsideratë mangësitë në sistemin e shitjeve dhe rekomandimet për adresimin e këtyre mangësive. Ju lutemi vini re se ky raport adreson vetëm mangësitë e identifikuar gjatë auditimit dhe nëse testime të mëtejshme janë kryer, atëherë mund të jenë raportuar më shumë mangësi. Ky raport është vetëm për përdorimin e menaxhmentit dhe nëse keni pyetje të mëtejshme, atëherë ju lutemi mos hezitoni të na kontaktoni.

Sinqerisht Juaji

Mangësitë	Kontrollet
<p>Agnesa nëpunësja e shitjes merr porositë e klientëve, mbledh faturat e shitjeve dhe përpunon pagesat për klientët e hotelit. Kjo është një mungesë e ndarjes së detyrave dhe mund të çojë në rrezik për transaksione mashtruese ose gabime, pasi askush nuk kontrollon punën e kryer nga ky nëpunës.</p>	<p>Një tjetër nëpunës i librit të shitjeve duhet të përfshihet në përpunimin e transaksioneve të klientëve të hotelit, në mënyrë që asnjë individ të mos marrë përsipër të gjitha elementet e ciklit të shitjeve. Puna mund të ndahet në mënyrë që një nëpunës të mbledhë porositë dhe faturat, por një nëpunës i dytë përpunon pagesat.</p>
<p>Klientët e hoteleve kanë kontraktuar çmimet e shitjes; megjithatë, duke qenë se çmimet e tregtisë online ngarkohen automatikisht në faturat e shitjes, Agnesa duhet t'i ndryshojë manualisht faturat.</p> <p>Kjo rrit ndjeshëm rrezikun e gabimit, pasi nëse Agnesa i rrit gabimisht çmimet e shitjes, atëherë kjo mund të çojë në humbjen e vullnetit të mirë të klientit dhe nëse ato janë shumë të ulëta, kjo rezulton në humbje të të ardhurave për Picrrakun.</p>	<p>Duke qenë se klientët e hoteleve përbëjnë 40% të të ardhurave, duhet t'i kushtohet vëmendje ndryshimit të sistemit të shitjeve në mënyrë që çmimet e dakorduara të secilit klient të jenë të ngarkuara paraprakisht, prandaj nuk do të kërkohet ndryshim manual i faturave. Nëse kjo nuk është e realizueshme, atëherë të gjitha faturat e shitjeve për klientët e hotelit duhet të kontrollohen dy herë nga një anëtar tjetër i departamentit të financave përpara se të dërgohen.</p>
<p>Kufijtë e kredisë përcaktohen nga drejtori financiar kur një klient i ri tregtar krijohet në sistem. Megjithatë, këto kufij mund të jenë të vjetruara, duke rezultuar që kufijtë të jenë shumë të lartë dhe shitjet të bëhen te klientët që nuk kanë aftësi pagese ose shumë të ulëta dhe Picrraku të humbasë të ardhurat e mundshme.</p>	<p>Kufijtë e kredisë së klientit duhet të rishikohen rregullisht nga drejtori financiar dhe të përditësohen bazuar në nivelin e transaksioneve të shitjeve dhe rrezikut të kredisë.</p>
<p>Porositë e klientëve dhe fletëdërgesave u jepet një numër bazuar në numrin e llogarisë së klientit dhe numrin e porosisë. Këta numra nuk janë të njëpasnjëshëm. Pa numra të njëpasnjëshëm, është e vështirë për Picrrakun të identifikojë porositë që mungojnë dhe të monitorojë nëse të gjitha porositë po dërgohen në kohën e duhur, duke çuar në humbjen e vullnetit të mirë të klientit.</p>	<p>Porositë e shitjeve dhe fletëdërgesat duhet të numërohen në mënyrë të njëpasnjëshme. Në baza të rregullta, duhet të ndërmerret një kontroll i radhës i porosive për të identifikuar çdo porosi që mungon. Pas dërgimit, fletëdërgesa duhet të përputhet me porosinë; duhet të ndërmerret një rishikim i rregullt i porosive të pakrahasueshme për të identifikuar ndonjë porosi të papërbushur.</p>

Mangësitë	Kontrollet
Picrraku ka ndryshuar nga një kompani korrierësh kombëtare e besueshme në një korrier vendas më të lirë; si rezultat disa porosi janë dorëzuar me vonesë. Ekziston rreziku që porosinë të humbasin duke rezultuar në humbje të të ardhurave për Picrrakun ose porosinë që mbërrin më vonë se normalja, gjë që do të çonte në humbjen e emrit të mirë të klientit.	Kompania e korrierit duhet të vendosë objektiva në lidhje me afatet kohore të dërgesave. Duhet të ndërmerret një rishikim i kohës së synuar të dërgimit dhe kohëve aktuale të marra nga kompania e re e korrierëve. Nëse vonesat vazhdojnë, atëherë duhet të merret parasysh ndryshimi në kompaninë origjinale të korrierit.
Faturat e shitjeve të klientëve të tregtisë gjenerohen automatikisht nga sistemi në të njëjtën kohë që bëhet porosia online. Megjithatë, nëse mallrat nuk dërgohen menjëherë, atëherë klientët mund të faturohen para marrjes së mallrave të tyre. Kjo ka të ngjarë të çojë në një humbje të emrit të mirë të klientit dhe njohjen e hershme të të ardhurave në të dhënat e kontabilitetit.	Sistemi duhet të ndryshohet në mënyrë që të lidhet me sistemin e dërgimit. Faturat e shitjes nuk duhet të lëshohen derisa mallrat të jenë dërguar.
Nëse Picrraku bën oferta speciale ose zbrit në shitje, të dhënat e skedarit kryesor për çmimet e shitjeve ndryshohen nga një nëpunës i lartë i librit të shitjeve. Ekziston rreziku që këto ndryshime të bëhen gabimisht, duke rezultuar në humbje të të ardhurave nga shitjet ose mbingarkesë të klientëve.	Kur ndodhin oferta speciale ose shitje me zbritje, ndryshimet në të dhënat e skedarit kryesor duhet të bëhen nga një mbikëqyrës dhe çdo ndryshim të kontrollohet nga një zyrtar përgjegjës për të zvogëluar rrezikun e gabimeve.
Për më tepër, nëpunësi i librit të shitjeve, edhe pse senior, nuk është aq pozitiv e lartë sa të mund t'i jepet qasje në ndryshimin e të dhënave të skedarit kryesor, pasi kjo mund të rrisë rrezikun e mashtrimit.	Ndryshimi në të dhënat e skedarit kryesor duhet të kufizohet në mënyrë që vetëm mbikëqyrësit dhe pozitat më lart të mund të bëjnë ndryshime.
Kartelat mujore nuk u dërgohen klientëve tregtarë. Nëse kartelat nuk dërgohen rregullisht, kjo rrit gjasat që gabimet dhe çdo faturë kontestuese të mos identifikohet dhe zgjidhet shpejt nga Picrraku.	Picrraku duhet të prodhojë kartela mujore të klientëve si për klientët e hoteleve ashtu edhe për klientët e tregtisë dhe t'i dërgojë ato menjëherë.
Llogaria e kontrollit të librit të shitjeve rakordohet vetëm në fund të shtatorit për të verifikuar bilancin e fundvitit. Nëse libri i shitjeve rakordohet vetëm çdo vit, ekziston rreziku që gabimet të mos zbulohen menjëherë.	Llogaria e kontrollit të librit të shitjeve duhet të rakordohet në baza mujore për të identifikuar ndonjë gabim. Barazimet duhet të shqyrtohen nga një zyrtar përgjegjës dhe duhet të evidentojnë shqyrtimin e tyre.

(b) Procedurat thelbësore për të hyrat

- Krahasoni nivelin e përgjithshëm të të hyrave kundrejt viteve të mëparshme dhe buxhetit dhe hulumtoni çdo luhajtje të rëndësishme.
- Merrni një listë shitjesh për vitin të ndarë në dy kategori të klientëve hotelierë dhe tregtarë dhe krahasoni këtë me listën e vitit të kaluar dhe për çdo lëvizje të pazakontë diskutoni me menaxhmentin.
- Llogaritni marzhin bruto të fitimit për Picrrakun dhe krahasoni atë me vitin e kaluar dhe hulumtoni çdo luhajtje të rëndësishme.

- Zgjidhni një mostër të faturave të shitjes për klientët e hoteleve dhe rakordoni për çmimet e shitjes përsëri në tarifat e kontraktuara për të siguruar saktësinë e faturave.
- Zgjidhni një mostër të notave të kreditit dhe gjurmoni deri në faturën origjinale dhe sigurohuni që fatura të hiqet saktë nga shitjet.
- Zgjidhni një mostër të porosive të klientëve tregtarë të vendosura në internet dhe përputhni këto me fletdërgesa dhe faturat e shitjeve deri në përfshirjen në librin e shitjeve për të siguruar plotësinë e të hyrave.
- Zgjidhni një mostër të fletdërgesave para dhe pas fundit të vitit; ndiqni këto deri te faturat e shitjeve në periudhën e duhur kontabël për të siguruar që prerja është zbatuar saktë.

Detyra 5

Ju jeni auditori i jashtëm i Premium Store Shpk (PS) për vitin e mbyllur më 31 mars 2021. PS operon me 12 dyqane ushqimore në zonën e Prishtinës:

- Çdo dyqan shet ushqime dhe përmban një seksion për përgatitjen e senduiçëve.
- Çdo dyqan është përgjegjës për blerjen e stoqeve të saj dhe përgatit pasqyrat meanxheriale mujore të cilat i dërgohen departamentit të kontabilitetit të centralizuar në zyrën qendrore të PS.

PS financohet nga një kredi bankare 250,000 Euro e cila është e shlyershme me një normë prej 50,000 Euro në vit për secilin nga 5 vitet e ardhshme duke filluar nga 31 tetor 2021. Ajo gjithashtu ka një kontratë për mbitërheqje prej 100,000 Euro të cilën e përdor plotësisht. Kontrata për mbitërheqje bankare pritet të rinovohet më 1 maj 2022. Banka i ka thënë tashmë kompanisë se do t'i duhet të përgatisë një parashikim të rrjedhës së parasë për dy vitet nga 1 shkurt 2022, në mënyrë që banka të vendosë nëse do të rinovohet mbitërheqja ose jo. Banka ka thënë gjithashtu se do të kërkojë një raport nga auditorët e jashtëm për të konfirmuar saktësinë e parashikimit.

Kërkohe:

(a) Përshkruani çka nënkuptohet me 'procedura analitike'; dhe (3 pikë)

(b) Në lidhje me punën e një auditori të jashtëm:

(i) Përshkruan KATËR procedura analitike që duhet të kryhen për të konfirmuar të hyrat dhe fitimin e PS. (4 pikë)

(ii) Përshkruani procedurat thelbësore që duhet të kryhen për të verifikuar secilin nga pohimet e mëposhtme:

- Vlerësimi i stoqeve. (5 marka)
- Plotësia e të pagueshme. (4 pikë)

(iii) Rekomandoni procedurat e duhura thelbësore që duhet të kryhen për të konfirmuar kredinë bankare të PS. (4 pikë)

[Gjithsej: 20 pikë]

Zgjidhja

(a) Procedurat analitike përfshijnë vlerësimin e informacionit financiar dhe jofinanciar dhe krahasimin e rezultateve aktuale me pritshmëritë. Ato përfshijnë gjithashtu identifikimin e luhatjeve dhe marrëdhënieve të rëndësishme që devijojnë nga pritshmëritë. Pritshmëritë duhet të zhvillohen bazuar në njohuritë e auditorit për operacionet e kompanisë gjatë periudhës në shqyrtim dhe informacionit të marrë nga kryerja e testeve të tjera të auditimit.

(b) (i) Katër procedura analitike

- Rishikoni shitjet mujore për çdo pikë të ndara për produkte ushqimore, ushqime të përgatitura
- Krahasoni marzhet e fitimit për shitjet nëpër dyqane
- Rishikoni vlerësimin e shitjeve në kosto dhe krahasoni me të hyrat
- Rishikoni nivelin mesatar të humbjes së stoqeve të dyqanit për çdo pikë shitjeje
- Krahasoni nivelet aktuale të shitjeve për dyqan me buxhetin

(ii) Procedurat thelbësore (1 pikë për secilën procedurë të shpjeguar siç duhet)

Vlerësimi i stoqeve

- Verifikoni faturat e mostrës për furnizuesin për të përcaktuar koston
- Diskutoni metoda e përafrimit të koston me menaxhmentin dhe krahasimi me çmimet aktuale në të tre fushat e produkteve ushqimore, ushqimet tjera dhe sanduiqet
- Ekzaminoni çmimet e shitjeve pas fundit të vitit për të konfirmuar $VNR > kosto$ për stoqet e dyqanit
- Ndjekni një mostër artikujsh të mbajtur në stoqet e dyqanit me faturat e blerjes për të verifikuar koston
- Merrni parasysh nivelin e stoqeve që prishen të mbajtur në numërimin e stoqeve dhe rishikoni vlerësimin në fund të vitit

Plotësia e të pagueshmeve

- Rishikoni në mënyrë analitike nivelin e të pagueshmeve ky vit me vitin e kaluar
- Dërfoni konfirmimet e llogarive të pagueshme dhe rishikoni kartelat e furnitorëve
- Rishikoni librin e parave të gatshme për pagesat e bëra ndaj furnitorëve pas fundit të vitit
- Llogaritni ditët e pagueshme dhe hetoni diferencat e rëndësishme

(iii) Kredia bankare

- Inspektoni marrëveshjen e huasë për shumën e marrë hua dhe dëshmi për çdo marrëveshje/kusht
- Konfirmim i drejtpërdrejtë nga huadhënësi për rikthimin e huasë dhe interesit/sigurisë së papaguar
- Sigurohuni në ndarjen e duhur midis detyrimit afatshkurt dhe atij afatgjatë
- Sigurohuni në tarifën e interesit dhe çdo interes akrual të regjistruar me saktësi